



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

Peqin 08.02.2019

**SHPALLJE PËR LËVIZJE PARALELE
DHE NGRITJE NE DETYRE NE KATEGORINE E MESME DREJTUESE
(Drejtor te Sherbimeve Bujqesore, Veterinere e Pyjeve)**

**Lloji i diplomës “Juridke /Shkenca Ekonomike/Zooteknik i larte.
Niveli minimal i diplomes “ Master Shkencor/DND.**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, IV dhe VI të VKM nr Nr. 243, datë 18.3.2015, **Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Peqin** shpall procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë jashtë shërbimit civil për pozicionin::

Drejtor te Sherbimeve Bujqesore, Veterinere e Pyjeve **Kategoria e pagës II-B.**

Pozicioni më sipër u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele ne shërbimin civil!

Vetëm në rast se, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës te ngritjes ne detyre jashte shërbimit civil.

Për të gjitha procedurat (lëvizje paralele, ngritje në detyrë jashte shërbimit civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për

LËVIZJE PARALELE:18.02.2019

Afati për dorëzimin e dokumentave për

**NGRITJE NE DETYRE(jashte shërbimit
civil):25.02.2019**

PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS PËR POZICIONIN MË SIPËR ËSHTË:

I. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

- II. Zbatimi i detyrimeve të percaktuara në aktet ligjore dhe nenligjore që lidhen me administrimin, menaxhimin, mbrojtjen e tokës dhe pyjeve. Rehabilitimi dhe investimi në infrastrukturën bujqësore. Promovimi dhe marketingu i produkteve bujqësore duke nxitur dhe mbështetur kultivimin e kulturave dhe specieve tradicionale për çdo zonë. Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të njerezve nga sëmundjet zoonotike (sëmundje të trashëgueshme nga kafsha tek njeriu), nga toksiinfeksionet apo infeksionet nga lende me elemente toksike, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm sanitaro-veterinar të produkteve me origjinë shtazore etj. Zbatimi i akteve ligjore mbi sigurinë e digave/dambave, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e tyre, me qëllim realizimin e kërkesave komplekse (ose të veçanta) të shfrytëzimit të burimeve ujore, sigurinë e popullatës dhe vlerave ekonomike në basen dhe poshtë tij, në të gjitha etapat e jetës së digës/dambës.

III. DETYRAT KRYESORE

Detyrat e Drejtorit të Sherbimeve Bujqësore, Veterinere e Pyjeve

1. Drejtori i Drejtorisë së Sherbimeve Bujqësore, Veterinere e Pyjeve, Drejton, organizon dhe kontrollon aktivitetin e Drejtorisë në zbatim të akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi.
2. Merr pjesë në procesin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të drejtorisë në përputhje me ligjin organik të buxhetit dhe aktet nenligjore në zbatim.
3. Jep kontribut në procesin e vendimmarrjes, për çështje që janë në kompetencë të drejtorisë dhe në përputhje me legjislacionin.
4. Të përgatisë materiale informuese, relacione ose projekt-vendime për miratim në Këshillin e Bashkisë që përfshijnë fushën e veprimtarisë së drejtorisë.
5. Kordinon punën për administrimin dhe mbrojtjen e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve, si toka të pafrytshme etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
6. Përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të strategjive, planeve, programeve e projekteve brenda kompetencave të Bashkisë, nxit zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale dhe të ruhet mjedisi, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre;
7. Evidenton probleme që dalin nga veprimtaria e përditëshme si dhe shqetësime të ndryshme që ngrihen me shkrim nga qytetarët, përcakton zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe i propozon eprorit, rrugëzgjidhjet, përkatëse Organizon, merr masa dhe kontrollon punën për bërjen të njohur, pronarëve privatë, të dispozitave ligjore për mbrojtjen e tokës.
8. Bën azhurnimin periodik të dokumentacionit kadastral të tij dhe njofton seksionin e kadastrës në qark për të bërë ndryshimet që ai administron, zbaton vendimet e organeve kompetente për ndryshimin e kalimin në gjendjen e pronësisë së tokave dhe rakordon me seksionin e kadastrës në Qark.
9. Grumbullon të dhënat dhe kryen procedurat për shfrytëzimin e resurseve që me ligj i kalojnë Bashkisë dhe shtë përgjegjës para organeve drejtuese të Bashkisë për shfrytëzimin e resurseve.
10. Krijimin dhe administrimin e sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural, sipas legjislacionit në fuqi.
11. Trajton dhe jep përgjigje për të gjithë procedurën e verifikimit dhe përcjelljes për regjistrim të AMTP, të ardhur nga fermeret apo nga ZVRPP dhe plotësimin e dokumentacioneve përkatëse të pronësive private.
12. Evidentimi, promovimi, bashkëpunimi me programe dhe donatorë që veprojnë në fushën e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, për të rritur mbështetjen e fermerëve në përfitimin e granteve..
13. Siguron mbështetje me asistencë teknike të vazhdueshme të fermerëve për rritjen e prodhimit dhe të cilësisë së produkteve bujqësore e blegtorale.

14. Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, mbrojtjes nga permytja, të transferuar në pronësi të Bashkisë, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
15. Kontrollon zbatimin e planit të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes të objekteve ujtese, kulluese dhe veprat e mbrojtjes nga permytjet, rezervuaret etj.

16. Merret me administrimin dhe zhvillimin e fondit pyjor e kullor publik, në përputhje me politikat dhe strategjitë e miratuara, legjislacionin në fuqi.
17. Bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjore, Ujrave dhe Turizmit për shkeljet dhe dëmtimet e konstatuara në fondin pyjor dhe kullor në pronësi të saj.
18. Mer masa dhe kujdeset për hartimin e planeve operacionale për aktivitetet vjetore në pyje dhe kullota, hartohet bazuar në të dhënat e planit të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave.
19. Organizon grupet e punës me qëllim studimin dhe përgatitjen e projekteve për investimet në pyje / kullota për parandalimin e gërryerjeve, rrëshqitjeve si dhe harton programet vjetore për ndërhyrje dhe investime.
20. Kërkon hartimin dhe ndjekjen rigoroze të programit të mbrojtjes së pyjeve nga zjarret.

21. Përgjigjet për mbulimin me shërbimin veterinar të të gjithë territorit të bashkisë në përputhje me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi.
22. Koordinon dhe bashkërendon punën me institucionet shtetërore kompetente, shërbimet homologe në rrethet e tjera të vendit (veçanërisht rrethet fqinj), si dhe me institucionet shëndetësore dhe të mbrojtjes së konsumatorit, për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me rritjen dhe forcimin e sigurisë së shëndetit të popullatës.
23. Informimin e vazhdueshëm të konsumatorit mbi tregjet, produktet, tregtimet e mallrave jashtë normave e standardeve higjienike, mungesën e dokumentacionit të origjinës së mallit dhe të certifikateve shëndetësore.

24. Organizon punën dhe merr masa për mbrojtjen e shëndetit të njerëzve nga sëmundjet zoonotike (sëmundje të trashëgueshme nga kafsha tek njeriu), nga toksinfeksionet apo infeksionet nga lende me elemente toksike, nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm sanitaro-veterinar të produkteve me origjinë shtazore.

25. Drejton bashkëpunimin me strukturat e Ministrive, strukturat paralele rajonale të Ministrive të linjës dhe institucionet e tjera, për sa i përket bashkëpunimit dhe ndjekjes së procedurave ligjore që kanë të bëjnë me detyrat përkatëse të drejtorisë.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kushtet minimale që duhet të plotësojë kandidati për këtë procedurë janë:

- a) Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- ç) Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si më poshtë:

Arsimi:

Arsimi i lartë – Diplomë në Ekonomik/Juridik/Zooteknik

Përvoja :

Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet .

Tjetër:

- Të ketë njohuri mjaft mira të gjuhës angleze, preferohet njohja e një gjuhe të dytë të BE.
- Të ketë aftësi të mira komunikuese, koordinuese dhe të punës në grup.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin, dokumentat si më poshtë:

a-Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b-Fotokopje të diplomës

c-Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);

d-Fotokopje të letërnjoftimit (ID);

e-Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

f-Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore / Vërtetim të gjendjes gjyqësore;

g-Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

h-Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

i-Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 18.02.2019

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **20.02.2019** Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit të Bashkisë, **listën e kandidatëve** që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta si dhe datën vendin dhe oren e sakte.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Pergjegjes i Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin, nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin de funksionimin e qeverisjes vendore”
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”
LIGJ Nr. 7501, date 19.7.1991“PER TOKEN” – *(I përditësuar)*
- LIGJ Nr.9244, date 17.6.2004“PER MBROJTJEN E TOKES BUJQESORE” – *(I përditësuar)*
- LIGJ Nr.9948, datë 7.7.2008 “PËR SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE” – *(I përditësuar)*
- LIGJ Nr. 9385, datë 4.5.2005“PËR PYJET DHE SHËRBIMIN PYJOR” - I NDRYSHUAR
- L I G J Nr. 10 465, datë 29.9.2011 “PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” - I NDRYSHUAR

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Struktura e ndarjes së pikëve të vlerësimit të kandidatëve është, si më poshtë vijon:

a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;

b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;

c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Peqin do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të Bashkisë.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për shpalljen e fituesit.

2 NGRITJE NE DETYRE

Në rast se pozicioni i cituar me sipër, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, vazhdon procedura e ngritjes në detyrë jashtë shërbimit civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë nëpunësit civilë të nivelit ekzekutiv, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë.

2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E NGRITJES NË DETYRË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA 2. NGRITJA NË DETYRË

Në rast se pozicioni i cituar me sipër, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, vazhdon procedura e ngritjes në detyrë.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati (Nëpunës Civil) në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” ose “Shumë mirë”;
- d- Të kenë mbaruar studimet e larta universitare niveli i diplomës “Master Shkencor”

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- a- Të kenë mbaruar studimet e larta universitare niveli i diplomës “Master Shkencor”

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Të kenë mbaruar studimet e larta universitare niveli i diplomës “Master Shkencor (shkenca Ekonomike, sociale, juridike”

2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët (nëpunës civilë) duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit;
- b- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- a- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Bashkinë e Peqinit brënda dates 25.02.2019

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 08.03.2019 Njbnj në Bashkinë Peqin do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e ngritjes në detyrë si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

2.4 KRITERET E VEÇANTA QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT QË APLIKOJNË NGA JASHTË SHËRBITM CIVIL

Kandidatët nga jashtë shërbimit civil duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Kjo procedurë është vendosur të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin e lirë (në zbatim të vendimit të titullarit por që nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik, neni 26/4). Këtë informacion do ta merrni në faqen e internetit të Bashkisë Peqin dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data **25.02.2019**.

- a- Të zotërojnë një diplomë sistem 4 – vjeçar apo Diplomë Master Shkencor në çdo fushë të arsimit. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë. (Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet.
- c- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- d- Të ketë njohuri të një gjuhe të huaj.
- e- Kërkesat për pranimin në Shërbimin Civil sipas nenit 21 të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

2.5 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.6 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 40 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 20 pikë.

2.7 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njbnj në Bashkinë Peqin do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).njesia e burimeve njerezore ne Bashkine e Peqinit do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e levizjes paralele si dhe ngritjes në detyrë jashtë shërbimit civil,do të marrin informacion në faqen e Bashkisë Peqin për fazat e mëtejshme të procedurës së konkurimit:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Bashkisë Peqin .Kandidatet pjesmarres ne kete procedure do te njoftohen individualisht ne menyre elektronike.

Specialiste e Burimeve Njerezore

/Edlira Elezi/

KRYETARI BASHKISE

/Saimir Hasalla/